



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-9178/1 i datës 07.11.2022, HIDHET POSHT.

Denoncimi të dorëzohet në Komisionin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi kundër RMV-së.

Lënda me numër 12-9178 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-9178/1 të datës 07.11.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për diskriminim ndaj parashtruesit nga një person zyrtar ///. Siç thuhet në denoncim, personi zyrtar i përmendur, duke ndërmarrë veprime dhe duke sjellë akte individuale, ka bërë diskriminim ndaj parashtruesit, i cili ka edhe cilësinë e personit zyrtar, si punonjës në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Pas mbikëqyrjes në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja konstatoi se autoriteti kompetent i autorizuar me ligj për të hetuar pretendimet në denoncim është Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i RMV-së, për këtë arsye e vlerësoi të nevojshme për t'ia përcjellë kërkesën me provat këtij autoriteti për veprim kompetent.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Parashtruesi
- Komisioni për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi i RMV-së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: S. P. D.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Нёнкрыетар
Mr. Vlladimir Georgiev

